



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.142/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP paraqitur kundër vendimit Nr.01/29-2025 datë 08.01.2024 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për miratimin e dizajnit të fletëvotimit dhe broshurës për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.01.2025, merr këtë :

VE N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa Anr.142/2025 datë 22.01.2025, të parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP, kundër vendim Nr.01/29-2025 datë 08.01.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për miratimin e dizajnit të fletëvotimit dhe broshurës për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP, kundër vendimit nr. Nr.01/29-2025 datë 08.01.2025 KQZ-së, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për miratimin e dizajnit të fletëvotimit dhe broshurës për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025

Parashtruesi i ankesës thekson se në bazë të Ligji nr. 081-228 neni 87 Përshkrimi i Fletëvotimit dhe materialit në lidhje me Fletëvotimin parag. 8 Fletëvotimet shtypen në të gjitha gjuhët zyrtare në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Subjekti politik i certifikuar mund të gjedh gjuhen dhe shkrimin në të cilin emri i tij/saj është i shkruar në fletëvotim.) dhe Rregullore Zgjedhore 10/2024, neni 6 (Përgatitja dhe miratimi i fletëvotimeve dhe broshurave) parag. 4 (Fletëvotimet dhe broshurat shtypen në të dy gjuhët zyrtare ndërsa në komunat ku është gjuha e tretë në përdorim zyrtar, vendoset si gjuhë në fletëvotim dhe broshura.) përcakton përmbajtjen e fletëvotimeve.

Më tej thuhet se Komisioni (KQZ), në bazë të ligjit dhe rregullores duhet të- përcakton gjuhët zyrtare dhe gjuha e tretë në përdorim zyrtar për çdo komunë, dhe me këto të bëjnë dizajnin e fletëvotimeve dhe broshurave për çdo komunë, në aspektin e gjuhës.

Ashtu që, në bazë të ligjit dhe ajo rregullores përkatës, sidomos në Komunitet e Prizrenit dhe ato Mamushë, fletëvotimet dhe broshurat duhet të jenë edhe në gjuhën Turke.

Me këtë ankesë, kërkojnë që të ndryshohet vendimi për fletëvotimeve dhe broshurave, dhe të bëhet me harmoni me ligjin 081-228 dhe e me rregulloren zgjedhore 10/2024.

Në përgjigje të KQZ-së, thuhet se më 8 janar 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë vendim Nr.01/29-2025, për Miratimin e Dizajnit të Fletëvotimit dhe Broshurës për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025, andaj ankesa e paraqitur nga subjekti politik KDTP në PZAP dhe dorëzuar nga PZAP për përgjigje në ankesë më 24 janar 2025 datën 24.01.2025, Nr. 07/6-226/2025, lidhur me kërkesën në A.nr.142/2025, të datës 24.01.2025 është bërë jashtë afatit ligjor.

Vendimi për Miratimin e Dizajnit të Fletëvotimit dhe Broshurës në mbledhjen e KQZ-së Nr.02/2025, të datës 08.01.2025, është miratuar me 9 vota për, dhe me 2 kundër, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që mbahen më 9 shkurt, 2025, ku vendimin e ka votuar edhe anëtarja e KQZ-së nga radhët e subjektit KDTP znj. Mufera Shinik.

Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, afati për parashtrimin e ankesave ndaj vendimeve të KQZ-së është 24 orë nga marrja e vendimit të kontestuar. Meqenëse vendimi për Miratimin e Dizajnit të Fletëvotimit është marrë më 8 janar 2025, ndërsa ankesa e subjektit politik KDTP është dorëzuar më 24 janar 2025, kjo nënkupton se është tejkaluar afati i përcaktuar ligjërisht.

Më tej thuhet se KQZ, gjatë vendimmarrjes së vendimit të lartë cekur është bazuar nën 87 të Ligjit nr.08L/228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 10/2024 Fletëvotimet dhe Broshurat.

Gjithashtu, njoftojmë se shtypja dhe printimi i fletëvotimeve është në fazën finale, ku me procedura të prokurimit është përzgjedhur Kompania " Cetus" në Republikën e Sllovenisë, dhe planifikohet që javën e ardhshme të transportohen në Kosovë.

Në këtë fazë të avancuar të procesit zgjedhor, çdo ndërhyrje në vendimin për miratimin e dizajnit të fletëvotimeve do të shkaktonte vonesa të konsiderueshme dhe do të rrezikonte realizimin e zgjedhjeve në kohën e caktuar. Për më tepër, kjo do të shkaktonte shpenzime shtesë dhe komplikime të panevojshme për institucionet përgjegjëse.

Bazuar në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe, ndërsa Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.

Bazuar në dispozitat ligjore në Ligji nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së përcakton se: PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, në nenet 27,6, 39,3, 41.546, 51,4, 548, 69,7, 77.5 80.3 942, 983, 100,3, 1021, 103.4 dhe 105.1.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/ L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj

natyre të KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Miratimi i dizajnit të fletëvotimeve nuk përfshihet në këto kompetenca, dhe për rrjedhojë, PZAP-i nuk ka juridiksion mbi këtë lloj vendimi.

Ndërkaq, në përgjigje të thelbit të çështjes, ankesa është e pas aftshme dhe nuk bie në fushën e vendimeve që mund të ankimohen në PZAP.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

-Ankesa është e pasaftshme.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë Vendim nr.01/29-2025 datë 08.01.2025 për Miratimin e Dizajnit të Fletëvotimit dhe broshurës ku në marrjen e këtij vendimi e ka votuar edhe anëtarja e KQZ-së nga radhët e subjektit KDTP znj. Mufera Shinik, ndërsa subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP ankesë kundër këtij vendimi e ka dorëzuar në PZAP më datë 24.01.2025, pas afatit ligjor.

Në nenin 39 paragrafi 3 të Ligjit nr.08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ndër të tjera thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it... mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Paneli pasi konstatoi se e njëjta është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.142/2025 datë 25.01.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.